



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.60/03- 27605/23
Kaçanik, 27.10.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **VIII (tetë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 27 tetor 2023 (e premte). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 13:00. Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK. Mungoj Betim Shala-LDK, Arben Thaqi-OJQ.

Nga Ekzekutivi i komunës në takim mori pjesë Pranvera Loku Zharku – DZHET.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e VIII-të (tetë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2023, data 27 tetor, me këtë :

REND PUNE

- 1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
- 2.Gjendja e bizneseve në Komunën e Kaçanikut ;
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri.Në saje të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete.

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbal ?

Procesverbali i mbledhjes se VII (shtatë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2023, u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e, **Aprovoj**

Procesverbalin e mbledhjes se VII (shtatë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2023, të datës 25.09.2023 / Lënda : 01Nr. 60/01-25007/23.

2. Gjendja e bizneseve në Komunën e Kaçanikut ;

znj. Pranvera Loku Zharku : Sipas raportit nga statistikat e regjistrimit të bizneseve. Gjithësej në periudhën nga 1 Janari e deri me datë 25.10.2023, janë regjistruar 143 biznese të reja.

Këto ndahen në SH.P.K. (Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) , 87 meshkuj 87 dhe femra 8, ndërsa B.I. (Biznese individuale) , meshkuj 32 dhe femra 15.

Dhjetë aktivitetet që shërbejnë më së shumti nga bizneset janë ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore 21 biznese , punime suvatim 18 biznese, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve 15 biznese.

Në funksion të biznesit lokal ekziston Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve . Përmes kësaj qendre komuniteti i biznesit mund të regjistrojnë apo themelojnë veprimtarinë biznesore vetëm përbrenda pak orëve. Poashtu, përmes saj bëhet edhe ofrimi informativ për investitorët potencial, gjithashtu jepen këshilla ndaj bizneseve fillestare dhe atyre ekzistuese në plotësimin e aplikacioneve të ndryshme si plan bizneseve me qëllim të qasjes më të lehtë në financa apo mjete fikse që mund të përfitohen nga donatorët e ndryshëm.

QKRB në Kaçanik gjatë periudhës raportuese bëri këto punë bizneset të reja 135, ndryshime në biznes 59, shuarje të bizneseve 12, certifikata të reja 31, certifikata dublikatë 21, informatat e biznesit 100, vërtetim që nuk ka biznes të regjistruar 5, vërtetim për tender 48.

Nga 135 biznese , 72 nga këto janë individuale ndërsa, 63 Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Nga këto shifra 106 biznese menaxhohen nga meshkujt ndërsa 29 nga femrat. Ndryshimet e bizneseve kanë qenë të ndryshme si ndryshim adrese, ndryshim aktiviteti, ndryshim emri tregtar, ndryshim përfaqësuesi të autorizuar apo drejtori menaxhues etj. Shuarjet e bizneseve kanë qenë të gjitha biznese individuale.

znj. Arta Avdiu : A keni futur ndonjë përparësi që menaxhohet prej grave me qëllim që të motivohen gratë me hap biznese. A kanë ndonjë dallim bizneset që menaxhohen nga gratë nga bizneset e tjera?

znj. Pranvera Loku Zharku: Vizitat që i kemi realizuar në teren, kanë qenë me qëllimin që të bëhet identifikimi i kategorive të bizneseve të cilat kanë nevojë për ndihmë.

Në të gjitha bizneset numri i të punësuarave gra, bizneset e vogla janë ato biznese që menaxhohen prej gjinisë femërore siç janë: frizeret, rrobaqepëset dhe të rralla janë prodhues.

Në këtë vit kemi pas 40,000.00 € subvencione dhe nga vizitat në teren e kemi vërejtur që këto mjete janë më të nevojshme me u ndarë për gra, andaj edhe e kam hapur thirrjen vetëm për bizneset që menaxhohen nga gratë.

Me 15 qershor kemi hap thirrjen ku kanë aplikuar 11 biznese, ndërsa 8 biznese kanë përfituar dhe 3 bizneset e tjera nuk kanë përfituar për shkak mungesës së dokumentacionit.

Shuma maksimale ka qenë 2000 euro d.m.th. subvencionet kanë qenë 50/50 d.m.th. 50% komuna , 50 % vet biznesi.

Në kuadër politikave zhvillimore, për bizneset për investitorët e huaj dhe vendore ofrohet prona komunale falas për shfrytëzim, këto prona jepen për afatgjatë 99 vjet, kjo bëhet përmes kuvendit, 45 vjet dhe 1-15 vjet me afatshkurtër.

z. Ekrem Livoreka : A ka ndonjë kërkesë për këto prona nga bizneset ?.

znj. Pranvera Loku Zharku : Po ka disa kërkesa, mirëpo këto kërkesa nuk bëhen te Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik sepse në menaxhim i ka Drejtoria e Urbanizimit dhe Kadastrit.

Me qëllim të lehtësimit të bizneseve gjatë kohës së pandemisë janë hequr taksat për ushtrim të veprimtarisë së biznesit andaj janë duke operuar pa asnjë taksë komunale.

z. Ekrem Livoreka : Gjatë kohës së pandemisë, sa biznese janë mbyllur dhe sa biznese janë rikthyer pas pandemisë, a posedoni ndonjë statistikë për këtë?

znj. Pranvera Loku Zharku : Kemi pasur një fluks të regjistrimit të bizneseve, për momentin nuk kame ndonjë të dhënë statistikore mirëpo mundem me ju sigurua këtë informata nga zyrtarët.

z. Ekrem Livoreka : Sa janë dëmtuar bizneset e vogla nga bizneset e mëdha siç janë Viva, Etc, a keni ndonjë mundësi me i mbështet me qëllim që këto biznese të mbijetojnë pasi që me të vërtetë bizneset e vogla janë dëmtuar shumë?

znj. Pranvera Loku Zharku: Janë dëmtuar, por jemi në një konkurrencë të lirë të tregut andaj nuk mund ti mohet askujt e drejta qoftë biznesit të madh apo atij të vogël.

znj. Arta Avdiu : Në Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik është vetëm një zyrtar për regjistrimin e bizneseve, a është i mjaftueshëm për nevojat e regjistrimit të bizneseve? E cekët që janë mbyllur 12 biznese, a është ky numër shqetësues?

znj. Pranvera Loku Zharku: Jo nuk është shqetësuese për shkak se zakonisht bizneset që mbyllen janë pasive, çdo vit 10 deri 20 biznese mbyllen dhe kjo është normale.

z. Ekrem Livoreka : Sa biznese nuk janë regjistruar dhe punojnë ilegalisht?

znj. Pranvera Loku Zharku: Me atë punë merret inspektorati, nuk është në menaxhim të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik!

znj. Arta Avdiu : Vendosija për rrugën një kahore për rrugën “Qamil Ilazi”, e ka vështirësua çështjen e bizneseve, a keni menduar me ndërmarr ndonjë vendim në lidhje me këtë çështje për me ju lehtësua ushtrimin e veprimtarisë së bizneseve në atë rrugë?.

znj. Pranvera Loku Zharku: Në fillim është kërkuar që të bëhet rrugë një kahshe për shkak të ngarkesës shumë të madhe të rrugës “Qamil Ilazi”, mendojë që problemin e kanë sjell parkingjet sepse me njërin anë janë berë dhe në njërin anë nuk ju pengojnë bizneseve ndërsa në anën tjetër ju pengojnë. Jam e informuar që ka një peticion nga bizneset dhe banorët e rrugës “Qamil Ilazi”, mirëpo ai peticion nuk ka ardhur tek drejtoria jonë por është adresuar ne Drejtorinë Shërbimeve Publike. Unë kam biseduar dhe kam thënë që duhet me tërheq mbrapa këtë ose me i largu parkingjet –vendimin,

sepse bizneset janë dëmtuar ndërsa nga drejtori kam marrë një përgjigjeje sipas të cilës është vetëm duke u testuar.

3. Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme ? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 13:40.

**Procesmbajtësja
Mavije Murseli**



**Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka**

